



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	775/22
Nr. i fq. / Br. st	-02-
Data: / Datum	10.06.2022
VUSHTRRI - VUÇITRN	

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE			
Nr./Br./No	3602-01	Nr. i faq./Br. str./No. pg	211
Data / Datum / Date	13 / 06 / 2022		
PRISHTINË			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*  
*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine*  
*Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

**Komuna e Vushtrisë**  
**Municipality of Vuçitrn**  
**Opština Vushtrri**

Prishtinë, \_\_\_/\_\_\_/2022

Duke u bazuar në nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7/ 01 Mars 2019), dhe neni 8, nënparagrafi 1.4 i Rregullores (QRK) Nr. 02/2022 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, lidhet kjo:

### **ANEKS MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR PROJEKTIN “PARKU INDUSTRIAL NË LUMADH”**

#### **Palët nënshkruese**

1. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e përfaqësuar nga Ministrija (në tekstin e mëtejme MINT) dhe
2. Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

#### **Neni 1** **Qëllimi**

1. Me këtë Aneks Marrëveshje ndryshohet dhe plotësohet Marrëveshja e Bashkëpunimit për Projektin “Parku Industrial në Lumadh” me numër protokollit 5041 të datës 16.07.2018 dhe aneks marrëveshjes me numër protokollit 9583 të datës 24.12.2020.
2. Qëllimi i ndryshimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër protokollit 5041 të datës 16.07.2018, si dhe aneks marrëveshjes me numër protokollit 9583 të datës 24.12.2020, është për shkak të mos përfundimit të projektit brenda afatit të paraparë në nenin 2 të marrëveshjes bazë dhe aneks marrëveshjes.

3. Nga momenti i pranimit teknik të projektit, Parku Industrial në Lumadh do të menaxhohet nga Komuna e Vushtrrisë, si në aspektin e mirëmbajtjes, ruajtjes së investimeve dhe sigurimin e hapësirave.

## **Neni 2** **Financimi i projektit**

1. Vlera e parashikuar e investimit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021 do të vazhdoj edhe në vitin 2022, si dhe palët pajtohen se obligimet e tyre të marrëveshjes bazë dhe aneks marrëveshjes t'i përmbushin gjatë vitit 2022.

## **Neni 3** **Amendamentet**

1. Aneks marrëveshja është pjese përbërëse e marrëveshjes bazë me numër protokollit 5041 të datës 16.07.2018 dhe aneks marrëveshjes me numër protokollit 9583 të datës 24.12.2020.
2. Kjo aneks marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e të dy palëve nënshkruese të aneks marrëveshjes.

## **Neni 4** **Kopjet e aneks Marrëveshjes**

1. Kjo aneks marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga dy (2) kopje.

## **Neni 5** **Hyrja në fuqi**

1. Kjo aneks marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.



Rozeta Hajdari

Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës së Vushtrrisë